



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA BERAT
SEKTORI I AUDITIMIT TE BRENDSHËM**

RREGULLORE E BRENDSHME

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E VEPRIMTARISË
SË SEKTORIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM PUBLIK“
BASHKIA BERAT**

VITI 2020

Dhjetor 2020

✚ Baza Ligjore e Veprimtarisë së Sektorit të Auditimit të Brendshëm.

Baza e veprimtarisë në fushën e auditimit të brendshëm është Ligji nr. 114/2015, date 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.

Ai përcakton rregullat kryesore për realizimin e procesit të auditimit të brendshëm për të garantuar kryerjen e auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare. Ky ligj rregullon veprimtarinë e auditimit të brendshëm në Njesinë e auditimit, si dhe përcakton: fushën e veprimit, objektivat, parimet, organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë.

Baza ligjore është sa më poshte:

- Ligji nr 139/2015 “Per vetëqeverisjen vendore”
- Ligji nr. 114/2015, date 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 806, datë 06.12.2006 “Për miratimin e metodologjisë së auditimit financiar”
- Urdhëri i Ministrit të Financave Nr. 100, datë 25.10.2016 “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik; me ndryshimet përkatëse, si Urdhëri i M. Financave Nr 4, date 10.01.2020 “ Per disa ndryshime në Manualin e Audituesve të Brendshëm” dhe Udhez.M. F nr 42, date 27.10.2020” Per ndjekjen e zbatimit te rekomandimeve te dhena nga auditi i brendshem në sektorin publik”

➤ Qëllimi, Misioni dhe Objekti i Punës së Sektorit të Auditit të Brendshëm

Auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur që jep siguri objektive dhe ofron këshillim për menaxhimin e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike. Auditimi i Brendshëm ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si edhe proceset e kontrollit dhe të qeverisjes.

Shërbimi i Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Berat ka për qëllim të :

- Ndihmojë njësitë e varësisë për të qenë të përgjegjshëm ndaj publikut, duke vlerësuar zbatimin e ligjit, rregulloreve, kontrolleve të vendosura, si dhe duke siguruar dobinë, frytshmërinë dhe kursimin e burimeve (ekonominë, efikasitetin dhe efektivitetin);
- Japë siguri objektive për organet mbikëqyrëse /titullarët, mbi saktësinë dhe besueshmërinë e raporteve financiare dhe raporteve të performances.
- Identifikojë dhe vlerësojë riskut, duke kontribuar në përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të riskut, vlerësimin e kontrolleve të cilat adresojnë riskun;
- Ndihmojë menaxhimin e lartë në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të tyre, duke përmirësuar sistemet e kontrollit dhe shërbimet e njësisë;
- Pengojë në mundësitë për mashtrim, shpërdorim dhe abuzim;
- Ndihmojë punonjësit të përmirësojnë performancën e tyre të punës dhe në respektimin e kontrolleve të vendosura.

✚ Fusha e zbatimit te Ligjit te Auditimit të Brendshëm Publik.

Ligji zbatohet për njësitë e sektorit public dhe perفشin:

a.Auditimin ei ndërmarrjeve dhe njesive buxhetore, drejtorite dhe sektoret të vartësisë së Bashkisë.

b. Shoqëritë tregëtare të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

c. Njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike sipas mareveshjeve ndërkombëtare.

✚ Organizimi i Sektorit të Auditit të Brendshëm të Bashkisë Berat.

Sektori i Auditit të Brendshëm në Bashkinë Berat funksionon me 3 auditues, 1 (një) Përgjegjës sektori dhe 2 (dy) specialist të auditit të brendshëm, të cilët janë të certifikuar në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.114/2015, “Për auditimin e brendshëm në njësitë publike”, si dhe VKM nr.83 , datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në njësitë publike”.

Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Berat varet dhe raporton drejtpërdrejt tek Titullari i institucionit për sa i përket përgjegjësisë dhe linjave të raportimit.

✚ Sektori i Auditimit të Brendshëm

Auditi i Brendshëm është një funksion i pavarur, i krijuar brenda strukturs së bashkisë për të vlerësuar dhe përcaktuar nëse:

1. Për kryerjen e operacioneve të ndryshme, janë ndjekur politika dhe procedura të pranueshme.
2. Jane respektuar ligjet dhe rregullat në fuqi.
3. Burimet janë përdorur me eficiencë dhe efikasitet.
4. Jane përmbushur efektivisht objektivat e planifikuara.
5. Eshtë përfutur dhe përdorur drejt informacioni financiar dhe operativ për vendim-marrjen.

Funksioni i Auditit të Brendshëm ka karakter konstruktiv dhe zhvillohet në frymën e bashkëpunimit me njësitë që auditohen, me synimin e gjetjes së rrugëve të përmirësimit në përmbushjen e objektiveve.

✚ Strategjia e Auditit të Brendshëm

Auditi i Brendshëm duke u bazuar në risk të cili ka të bëjë me probabilitetin që një ngjarje negative të shkaktojë shmangie apo mosrealizim të objektiveve harton strategjinë e mbrojtjes nga risku me hapat si më poshtë:

- a. Hapi i parë i strategjisë do të jetë përcaktimi i risqeve dhe listimi i aktiviteteve që paraqesin më shumë rrezik në lidhje me realizimin e të ardhurave dhe me kryerjen e shpenzimeve, etj. Keto janë aktivitete që do t'i nënshtrohen në mënyrë primare dhe frekvente auditimit.
- b. Hapi i dytë do të konsistojë në “alokimin” optimal të auditimeve sipas këtyre aktiviteteve.

✚ Fazat e punës së një audituesi, hapat që ndiqen për një angazhim auditimi.

Te gjitha dokumentat e punës që udhëzojnë një auditues gjatë angazhimit të auditimit vijojnë në katër faza :si faza e planifikimit të një angazhimi auditimi, puna në terren, raportimi dhe ndjekja e rekomandimeve.

Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor të Auditimit të Brendshëm përgatitet duke zbatuar standardet ndërkombëtare për auditimin e brendshëm.

Plani strategjik përcakton punën që do të ndermerret nga njësitë për periudha të ardhshme. Ky plan përditesohet çdo vit.

Plani Vjetor përcakton qartë me detaje gjithë veprimtarine e AB gjate vitit ushtrimor, përcakton objektivat për t'u arritur, treguesit e matjes së performacës së auditimit, kapacitetet në dispozicion si dhe vlerësimin e menaxhimit të riskut.

Plani i angazhimit të auditimit mbulon punën që do të ndermerret nga njesia e auditimit sipas hapave të mëposhteme:

- Njoftim i subjektit për auditim .
- Autorizim për auditim nga kryetari i bashkisë.
- Programi i auditimit .
- Plotesimi i deklaratave të konfliktit të interesit të audituesit për çdo auditim.
- Ndarja e detyrave midis audituesve.
- Hartim i projekt- raportit të auditimit .
- Organizimi i diskutimit të projekt -raportit (Takim pajtues).
- Hartimi i raportit përfundimtar të auditimit .
- Kontrolli dhe vlerësimi i cilesisë së angazhimit të auditimit.
- Plan veprimi nga subjekti i audituar bazuar në rekomandimet e auditit.
- Hartimi i memorandumit për titullarin.

Pas përfundimit të angazhimit të auditimit, hartimit të raportit përfundimtar dhe memorandumit.

Një kopje e dosjes me materialet e njesisë së audituar dorëzohet në arshiven e bashkisë pasi është e protokolluar .

Roli dhe përgjegjësitë e Përgjegjësit të Sektorit të Auditit të Brendshëm:

- Organizon, drejton dhe kontrollon gjithë aktivitetin e punës së strukturës së njesisë së auditimit.
- Në konsultim paraprak me Kryetarin e Bashkisë, nisur nga risku i subjekteve në auditim, madhësia dhe kompleksiteti, dhe me miratimin e tij, harton planin vjetor, planin strategjik dhe në përputhje me këto harton planet mujore.
- Merr pjesë në aududitime me të drejtë dhe përdorim të pakufizuar mbi çdo dokument dhe informacion zyrtar, pronë dhe personel, të cilat kanë lidhje me angazhimin e auditimit.
- Identifikon dhe vlerëson riskun, duke kontribuar në përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të riskut, vlerësimin e kontroleve të cilat adresojnë riskun;
- Të realizojë auditime në afatin e caktuar nga programet e kontrollit, konform të gjitha standarteve të kontrollit, duke plotesuar “Deklaratën e konfliktit të interesit të audituesit të brendshëm”, para çdo auditimi.
- Të jap opinione për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për subjektet në varesi.
- Të siguroj që programet e auditimit të jenë të mjaftueshme për të siguruar shqyrtim efektiv dhe të rregullt të të gjitha operacioneve mbi një cikël të planifikuar.
- Përcakton përgjegjësitë për objektivat e vendosura, rishikon cilesinë e punës së audituesve së bashku me përgjegjësin e grupit dhe vlerëson performancën e tyre.
- Garanton zbatimimin e metodave dhe procedurave të auditimit në përputhje me standardet ndërkombetare të auditimit.
- Harton raportin e auditimit (vlerësim teknik) në bashkëpunim me grupin e auditimit me të gjithë elementët e tjerë të dosjes së auditimit dhe ia paraqet për miratim Kryetarit të Bashkisë.
- Kontrollon veprimet e ndërmarra në përgjigje të rekomandimeve dhe të dobesive të konstatuara nga auditimi.

- Programon dhe realizon auditime të pa programuara, që mund të kerkohen nga Kryetari i Bashkisë.
- Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm kur nga audituesit e brendshëm janë konstatuar parregullshmeri apo veprime, që në vlerësimin e grupit të auditimit përbejnë vepër penale pas analizimit të gjetjes kur gjykon se parregullshmëria e evidentuar con në keqmenaxhim të rëndë financiar, mashtrim, shkatërim të pronës, shpërdorim të pronës, miraton ndërprerjen e angazhimit të auditimit, vetëm për çështjen për të cilën është konstatuar parregullshmëria. Drejtuesi i auditimit të brendshëm informon me shkrim Titullarin i cili pas vendimarrjes informon Nëpunësin e Parë Autorizues në M. Financave, zyrtarisht ku bashkelidhin dokumentacionin përkatës.
- Përgatit raportin vjetor, i cili i dërgohet Drejtorisë së Harmonizimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë sipas afateve të përcaktuara.
- Ndjek së bashku me audituesit rekomandimet e zbatimit të detyrave të Sektorit të auditimit të brendshëm dhe i paraqet titullarit të institucionit gjithë ecurinë e realizimit të tyre .
- Paraqet raporte përmbledhëse në mënyrë periodike dhe ben me dije Kryetarin e Bashkisë.

Roli dhe përgjegjësitë e specialistit të auditit të brendshëm :

- Të realizojë auditime në afatin e caktuar nga programet e kontrollit, konform të gjitha standarteve të kontrollit, duke plotësuar “Deklaratën e konfliktit të interesit të audituesit të brendshëm para çdo auditimi.
- Të respektojë në çdo rast dhe rrethanë gjatë kryerjes së detyrës kodin etiko-moral të nëpunësit civil dhe kodin etiko-moral të audituesit.
- Të njihet me të gjithë dokumentacionin që ka të bëjë me veprimtarinë a çështjen që do të auditohet.
- Të identifikoj dhe vlerësoj riskun, duke kontribuar në përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të riskut, vlerësimin e kontroleve të cilat adresojnë riskun;
- Të jap opinione për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për çdo angazhim auditimi.
- Merr pjesë në auditime me të drejtë dhe përdorim të pakufizuar mbi çdo dokument dhe informacion zyrtar, pronë dhe personel, të cilat kanë lidhje me angazhimin e auditimit. Nëse gjatë angazhimit të auditimit konstatohen parregullsi apo veprime, që në vlerësimin e tyre, përbejnë vepër penale informojnë me shkrim gjetjen tek drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm, ku bashkelidh dokumentacionin përkatës të gjurmës së auditimit.
- Harton projekt raportin e auditimit dhe raportin e auditimit në bashkëpunim me grupin e auditimit.
- Rekomandon masa për zhdëmtim e masa organizative në përmirësim të sistemeve të funksionimit të kontrollit të brendshëm.
- Të përgatisë të gjitha dokumentat që duhen konform standarteve dhe metodikave në fuqi të auditimit, për evadimin dhe plotësimin e dosjes së çdo auditimi të kryer, dorëzimin e saj në arkivën e institucionit të bashkisë.

Audituesve u ndalohe :

- Te kryejnë detyra të tjera brënda subjektit që auditohet .
- Te mbajnë nje mandate politik apo të jenë të zgjedhur në funksione drejtuese në strukturat e partive politike.
- Te ushtrojnë cdo veprimtari ose punë tjetër me pagese, apo të kenë përfitime të tjera të natyrave e formave, që krijojnë gjendje konflikti interesash me ushtrimin e auditimit, me perjashtim të mësimdhenies dhe publikimit, sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për nepunësin civil.

✚ Audituesit marrin pjesë në :

Kurse kualifikimi, trajnime të detyrueshme , 40 ore /vitë, ëorkshope që organizon Ministria e Financave, KLSH, Shoqata e Bashkive për të rritur me tej kualifikimin e tyre për zbatimin rigoroz të standarteve nderkombetare të auditimit dhe akteve ligjore e nenligjore.

**Pergjegjësi i Sektorit të Auditimit
Xhevahir MUZHAKA**